



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2018



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i III-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018

Më 25.06.2018

Në takim prezantuan:

Ylber Bajra, Nënkryetarë i Komunës

Afrim Halili , Komandant i Policisë-Kaçanik

Ali Vishi, përfaqësues i FSK-së

Kjani Sallahu, (mediet, OJQ-të, zejtarët, PAK-të)

Fatmir Qaka,EVSB

Ramadush Osmani-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencia

Zahir Doda- Drejtor i DAK

Jashar Selimi- Këshilli i Prindërve

Menduh Rexha-Bashkësia Islame

Shemsedin Abazi-(KLSP)

Monitorues: zyrtarë nga UNMIK-u

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës së Kaçanikut z. Ylber Bajra dhe propozoi këtë rend dite:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut
- 3.Diskutim rreth ankesave të qytetarëve që ndërlidhen me sigurinë e përgjithshme
- 4.Siguria gjat sezonit të verës
- 5.Të ndryshme

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar

- Procesverbali u miratua nga të pranishmit me disa gabime teknike që mbet të përmisohen

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut

-Reth kësaj pike raportoi **Komandanti i Policisë** i cili në fillim tregoi se me kërkesë të tij kjo mbledhje është shtyrë për sot pasi që si stacion i policisë kemi qenë të angazhuar në kërkim shpëtimin e dy policëve të ndjerë me qka falënderojmë të gjithë ata të cilët kontribuan në gjetjen e dy kufomave në lumin Lepenc.Kjo ka qenë edhe një nga arsyet që nuk kemi mundur të mbajmë një takim me KLSP për propozimin e një anëtarit të ri që do të përfajqsoj kët subjekt në KKSB.Takimi është mbajtur dhe është vendosur që përkohësisht KLSP-në në KKSB do ta përfajqsojë Shemsedin Abazi

Sa i përket gjendjes së sigurisë në Komunën tonë për momentin është e qetë dhe nuk ka indikacione për përkeqësim të situatës. Është shqetsuese dukuria e vjedhjes së derivateve të naftës në kompaninë Bechtelinka , kemi raste të kanosjes por që ne jemi marrë me këto raste me qka ka të arrestuar dhe rastet janëpërcjellë në gjykatë.

Viti shkollor ka përfunduar dhe ne kemi pasur disa aktivitete në luftimin e drogave me qka falënderoj drejtorët e shkollave për bashkpunim

Ne si stacion i policisë kemi hartuar planin operativ për sezonin e verës kur fluksi i njerëzve dhe automjeteve është më i madh , dasmat janë më të shpeshta , zhurma nëpër kafiteri është më e madhe dhe shpresoj që në bashkpunim me inspektorët komunal do të vendosim rend e qetësi

Ne gjithashtu kemi edhe një plan operativ të titulluar„Stop fajdeve dhe detyrimeve “ku edhe pse nuk kemi pasur ndonjë rast por që masat duhet ndërmarrë , andaj kërkoj bashkpunim me të gjithë akterët që të parandalojmë kët dukuri.

Falënderoj Bashkësinë Islame për bashkpunimin që kemi pasur për festën e Ramazanit dhe Bajramit ku nuk kemi pasur asnjë rast që është dashur të intervenohet.

Raste të radikalizmit dhe extremizmit të dhunshëm nuk kemi pasur dhe gjendjen e kemi nën kontrollë sa i përket kësaj dukurie.

Është brengosëse që qytetarët hezitojnë të japin informacione andaj nga ky takim inkurajojë ata që të bashkpunojnë me ne dhe të kenë besim tek Policia e Kosovës.

-Nënkryetari:Kohëve të fundit është prezente dukuria e vjedhjes së akumulatorëve dhe baterive por si shqetsim është edhe kërcënimi i inspektorëve komunal gjat kryerjes së detyrave të punës në teren

Ramadush Osmani:Qështja e asistimit të policisë në teren sipas mendimit tim nuk është si duhet dhe si brengë është edhe mos bashkpunimi i duhur me inspektorët komunal sidomos në sektorin e trafikut.

Ne si komunë jemi munduar të vendosim barriera në ato pjesë ku është e domosdoshme , gjithashtu kemi vendosur edhe shenja të komunikacionit nëpër rrugë por që ato po dëmtohen dhe nuk po mundën të kapen keqberësit.Kërkoj nga policia që të jet më aktive në parandalimin e këtyre dukurive.

Jashar Selimi:Policia të jet më aktive dhe në nivel të detyrës ngase në një rast në Kaçanik të Vjetër për një pronë kontestuese në prani të policisë ka mundur të eskaloj situata në mes qytetarëve.

Komandanti i Policisë:Dukuria e vjedhjes së derivateve të naftës ,baterive dhe akumulatorëve kanë filluar në punimet e autostradës por që është dukuri që po përhapet edhe në vende tjera dhe për këtë ne kemi një plan dhe jemi duke punuar në këtë drejtim për eliminimin e kësaj dukurie.Sa i përket kanosjes së zyrtarëve komunal ne nuk kemi kurrfar denoncimi dhe pa denoncim rastet nuk ndiqen edhe nëse policia është prezent por që reagohej që të mos vie deri te më e keqja.Personi që kanoset duhet të denoncojë rastin e mandej vijnë procedurat tjera që i takojnë policisë.

Në përgjithsi duhet ta kuptojmë se ne si polici nuk i kemi kushtet elementare për punë duke përfshi stafin jo të mjaftueshëm , automjetet për terene malore , radarë etj.Sa i përket rastit në Kaçanik të Vjetër ne kemi mbrojtur personin që posedonte letrat dhe dokumentacionet juridike për pronën .

Zahir Doda:Javën e kaluar kanë ndodhur vjedhje në dy shkolla dhe gjurmë mendoj se ka sa për të hetuar andaj kërkoj një angazhim më të madh nga policia që këto raste të zbardhen.

Dukuria e sjelljes së pakontrolluar të grupeve adoleshente nëpër rrugë në orët e vona është prezente edhe në prani të policisë.A mundet policia që të ndalojë këto grupe, ti dërgoj në polici dhe të thirren prindërit e tyre e të bisedohet me ta me qëllim që kjo dukuri të mos përsëritet.

Komandanti i Policisë:Jemi njoftuar për dy rastet e vjedhjes në dy shkolla dhe jemi duke punuar në zbardhjen e rasteve por që nuk kemi gjurmë të mjaftueshme.Bashkpunim konkret në zbardhjen e rasteve nuk kemi.Së paku kemi kërkuar që të na japin informacionet për presonat problematikë por nuk kemi marrë kurrfar informacioni.Sa i përket sjelljes së pakontrolluar të adoleshentëve nëpër rrugë në orët e vona duhet pranuar se kemi prind të papërgjegjshëm që nuk interesohen për fëmijët e tyre.

Kjani Sallahu: Më intereson të dijë se a ka ndodhë ndonjë takim në mes policisë së Kosovës ,Komunës dhe Kompanisë Bechtelenka dhe qka është diskutuar në këto takime .Gjithashtu kisha me ngritë një shqetsim në lidhje me marrjen e patent shoferit pa meritë .Janë ca examinerë që po përfitojnë nga kjo dukuri dhe dëshirojë të dijë se a ka të arrestuar apo a janë marrë masa ndaj këtyre individëve.

Komandanti i Policisë: Takime me zyrtarë të kompanisë në fjalë herë pas here kan ndodhur në teren por që ata nuk janë shumë serioz në bashkpunim.Takime konkrete në komunë nuk kemi pasur por që edhe nëse janë mbajtur ne nuk jemi ftuar.Shum probleme që janë shfaqur në pjesën ku punohet janë zgjedhë përmes Kryetarit të Komunës.

Sa i përket dukurisë së marrjes së patent shoferëve pa meritë edhe pse nuk është kompetencë e jonë e di që ka hetime , dyshime dhe akuza por që me këtë qështje mirret niveli qendrorë.

3.Diskutim rreth ankesave të qytetarëve që ndërlidhen me sigurinë e përgjithshme

-Në mungesë të kryesuesit të Komisionit Komunal për ankesa , kjo pikë e rendit të ditës mbeti të diskutohet në takimin e radhës

4.Siguria gjat sezonit të verës

-**Ramadush Osmani:**Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencia ka bërë një plan për mbrojtjen kundër zjarrit , i cili plan është miratuar në Kuvend Komunal . Kemi marrë të gjitha masat parandaluese duke bërë njoftime publike në gjith territorin e Komunës tonë,përmes ëeb. faqës së Komunës dhe rrjeteve sociale.Statistikat nga viti 2016 që kishte 168 raste të zjarreve , në vitin 2017 kemi pasur 161.Uroj që këtë vit të mos kemi nevojë të intervenojmë në asnjë rast.

5.Të ndryshme

Shemsedin Abazi:Rrjeti i ndriqimit publik në pjesën e qarshisë së vjetër nuk po funksionon dhe është shqetsim për qytetarët e kësaj ane.Në këtë pjesë po ashtu ka sjellje devijante të fëmijëve adoleshent të cilët deri në orët e vona frekuentojnë këtë pjesë duke krijuar probleme të natyrave të ndryshme.

-**Ramadush Osmani:**Jemi të njoftuar se kjo pjesë ka probleme me në rrjetin e ndriqimit publik.Ne kemi kompaninë e kontraktuar dhe do të bisedojmë që ky problem të zgjidhet sa më parë.

-**Kjani Sallahu:**Kanosja e zyrtarëve komunalë në kryerjen e detyrave të punës në teren është shqetsuese por që edhe këta zyrtarë duhen të kenë sjellje më të mira ndaj qytetarëve sepse janë në shërbim të tyre.Ka prova se këta zyrtarë provokojnë në situata të ndryshme. Të bisedohet me këta zyrtarë që të ndryshojnë qasjen ndaj qytetarëve.

-**Nënkryetari:** Zyrtarët komunal janë në shërbim të qytetarëve dhe sjelljet e tyre duhet të jenë në nivel të lartë të përgjegjshmërisë. Do të bisedojmë rreth kësaj qësjetje dhe me siguri se këto sjellje do të ndryshojnë për të mirë.

REKOMANDIMET:

1. Të forcohet niveli i bashkpunimit të Policisë së Kosovës dhe inspektorëve komunalë në parandalimin e dukurive negative që prishin rendin dhe qetësinë publike
2. Të rregullohet rrjeti i ndriqimit publik në pjesën e Qarshisë së Vjetër.
3. Të mirren masa ndaj frekuentimit të adoleshentëve në orët e vona
4. Policia të jet më aktive në zbardhjen e rasteve të dukurisë së vjedhjes
5. Të përmissohet sjellja e zyrtarëve komunal nraport me qytetarët
6. Të pengohet dukuria e marrjes së patent shoferit pa meritë dhe të mirren masa ndaj examinerëve

Pas këtyre rekomandimeve Nënkryetari përmbylli takimin për tu takuar në mbledhjen e radhës

Kaçanik 25.06.2018

Kryesuesi:

Nënkryetari i Komunës

z.Ylber Bajra



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka